



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-19-4242-2-3-6/C178
14 Nr. 573/19
Dt. 23.07.2019

KONTRATË SHËRBIMI
(Kontratë Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **MSS Mobile Sanitary Services “sh.p.k.** me seli në **Prishtinë**, me **NRB: 810530354**, të cilën e përfaqëson **z. Behxhat Haxholli**, në tekstin e mëtejshëm: **KRYESI I SHËRBIMEVE**,

janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve, si në vijim :
Pastrimi i xhamave dhe mirëmbajtja e fasadës së jashtme të objektit të komunës së Vushtrrisë , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	42	4	2	2	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	9	0	6	7	2	3	6

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Shërbime të pastrimit të xhamave (brenda dhe jashtë) dhe mirëmbajtja e fasadës së jashtme të objektit të komunës**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-19-067-236**
- 1.2 Kjo kontratë është **Kontratë Publike Kornizë** dhe fillon së zbatuari ditën e nesërme pas nënshkrimit të kontratës ndërsa, përfundon 12 muaj pas nënshkrimit të kontratës.
- 1.3 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim dhe / ose ekzekutim të shërbimeve me sasi të tyre përkatëse.
- 1.4 Sasi të parapara, si në pjesën II. Lista e Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Shërbimeve) dhe të kësaj Kontrate janë vetëm sasi indikative. Ato paraqesin një prag, nga e cili mund të lejohet një mospërputhje e cila nuk mund të jetë më e lartë se plus / minus tridhjetë përqind (30 %).
- 1.5 Nëse Urdhërblertjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të Kontratës Publike Kornizë, duke përfshirë edhe tridhjetë përqindëshin, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, Kontrata Publike Kornizë do të ndërpritet automatikisht.
- 1.6 Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlenë edhe për pozicion / artikull si në Përshkrim të Çmimeve, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar A.K. respektivisht Organi Mbuikëqyrës

- Komisioni i Pranimit të Shërbimeve nuk duhet të lejojë të bëhen porosi tjera dhe / ose të bëhen pranime tjera të shërbimeve për atë pozicion ose shërbim.
- 1.7 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen e shërbimeve të përmendura në pikën 1.1.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Ekzekutimi i shërbimeve do të filloi jo më larg se një javë (7 ditë kalendarike) pas dërgimit të ftesës Organi Mbikëqyrës - Komisioni i Pranimit të shërbimeve.
- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Furnizuesi.
- 3.2 Vlera totale indikativë e Kontratës është: 2.337,00€ (dymijtreqindtridhjeteshtatë/00 Euro).
- 3.3. Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve, me përjashtim nëse A.K. ka bërë porosi për furnizim me mall, duke shfrytëzuar edhe tridhjetpërqindëshin e lejuar sipas pikës 1.6. të nenit 1 të kësaj Kontrate Kornizë.
- 3.4 Pagesat do të bëhen : në pajtim me sasinë - e shërbimeve të porositura dhe të aprovuar nga Organi Mbikëqyrës - Komisioni i Pranimit të shërbimeve i Autoritetit Kontraktues.
- 3.5 Shumat do të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kushteve të kësaj Kontrate dhe Kushteve tjera të saktësuara në Dosjen e Tenderit.
- 3.6 Kontraktuesi ka për obligim që me rastin e fillimit të ekzekutimit të shërbimeve të respektoj detyrimet e tija në mënyrë që shërbimet të jenë cilësore, në përshtatshmëri të plotë me kushte e kontratës, të përmbushin në tërësi Specifikat Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoj Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës. Kontraktuesi merr për obligim që ekzekutimi i shërbimeve të porositura të bëhet të bëhet në mënyrë profesionale duke garantuar përdorim adekuat të preparateve hixhenike si dhe mjete pune të përshtatshme që garantojnë cilësi të shërbimeve dhe garanci për personelin e angazhuar në ekzekutimin e shërbimeve të porositura.

Neni 4 Ligji i aplikueshëm

- 4.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 5 Kualiteti

- 5.1 Kualiteti respektivisht cilësia e shërbimeve dhe / ose furnizimeve duhet, në të gjitha aspektet, të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 6 Garancioni

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

6.1 Garancioni i cilësisë dhe përshtatshmërisë së ekzekutimit të shërbimeve është përgjegjësi ekskluzive e Kryesit të Shërbimeve.

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve dhe / ose furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 9 Nën-kontraktimi

9.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

10.1 Autoriteti kontraktues mundet që të ndërpres Kontratën menjëherë pasi të konstatoi se Kryesi i Shërbimeve nuk po arrinë ta përmbushë Kontratën në pajtim me përshkrimin Teknik të saktësuar në Specifikimin Teknik të Dosjes së Tenderit.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

11.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

12.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

12.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 13 Komunikimi

13.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin :

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Saranda Cakaj	Emri:	Behxhet Haxholli
Pozita:	Drejtoreshë për Prokurim Publik	Pozita:	pronar
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	12.07.2019	Data:	12.07.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Numri i Prokurimit: VU644-19-4242-2-3-6 – Titulli Pastrimi i xhamave dhe mirëmbajtja e fasadës së jashtme të objektit të komunës

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr.	Njësia matëse	Sasia	Përshkrimi
1.	m ²	2850	Pastrimi i xhamave dhe mirëmbajtja e fasadës së jashtme të objektit të komunës

- Në çmim përfshihet furnizimi me material të pastrimit dhe pastrimi.
- Pastrimi I jashtëm të bëhet me mjete përkatëse pa e rrezikuar sigurinë e punëtorëve .
- Punëkryesi është I obliguar që vet t’I siguroj të gjitha mjetet, në menyrë që të arrij të pastroj çdo xham të fasadës.
- Pastrimi bëhet tre (3) herë brenda vitit, sipas kërkesës së AK-së.
- Punëkryesi është I obliguar ti përgjigjet porosisë (të filloj pastrimin) më së largu një (1) javë nga dita që AK (menaxheri I kontratës që do të caktohet) ka bërë porosinë për shërbim.

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8%-apo-18%. Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presëjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia indikative për 12 muaj	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH- së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)- €	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
1.1	Vërejtje: Në çmim përfshihet furnizimi me material të pastrimit dhe pastrimi								
1	Pastrimi i xhamave dhe mirëmbajtja e fasadës së jashtme të objektit të komunës	m ²	2,850.00	0.69	18.00	0.82	1,980.51	356.49	2,337.00
TOTALI 1:							1,980.51	356.49	2,337.00

W

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	Mobile Sanitary Services MSS Sh.p.k.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Behxht Haxholli
NËNSHKRIMI:	

DATA:	25.06.2019
VULA:	

